



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi / Punimori / Predalo / Received / Delivery	15.02.2022	2	viti / god. year
Organ / Institucia / Org. / Inst.	Id. Prot. Id. Prot. Prot. No.	Shtypja / Printog. Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKM/SHCK	791/2022		119



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1200/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani anëtarë si dhe Sabile Avdyli-bashkëpunëtore profesionale, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 6231/2021 të datës 20.12.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit- Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 15.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

I.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.1200/2021 e datës 20.12.2021, e parashtruar nga ankuesi

II.Mbetet në fuqi vendimi me numër protokolli 667/2021 i datës 23.07.2021 e Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi i caktuar në pozitën e “Inspektor Nacional “ sipas akt emërimit të datës 01.04.2013 me nr.Ref.DSP 16/2013. Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me datën 23.09.2021 ka nxjerr vendimin me numër protokolli 667 për pezullimin shtesave në pagë të cilat janë lejuar me vendimin nr.085 të datës 26.01.2017 në vlerën prej 107 Euro. Ankuesi i pakënaqur me vendimin e zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me datën 01.11.2021 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 791 për Zëvendësuesen e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesi pasi që nuk mori përgjigje nga Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 20.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6231/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.12.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme . Ministria e Punëve të Brendshme me datë 17.01.2022 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/11.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 20.12.2021 me numër protokoll 6231/2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokoll 667 i datës 23.09.2021; Shtojca 1.Shtesat e rrezikshmërisë në MPB sipas departamenteve dhe shuma; Ankesë e datës 01.11.2021 me numër protokoll 791 e parashtruar tek Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së; Kopja e kartelës identifikuese ; E-mail zyrtar i datës 13.09.2021, Arsyetimi për shtesën mbi pagën , implikimet financiare dhe baza ligjore për inspektorët nacional, Kartela e nëpunësit për e datës 01.11.2021 me numër protokoll 787,E-mail zyrtari datës 08.09.2021, E-mail zyrtar i datës 07.09.2021, Përgjigje në ankesë e datës 17.01.2022 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/11, Akt emërimi i datës 01.04.2013 për Vendimi i datës 26.01.2017 me nr.085 i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Raport i auditimit me kërkesë njësi për menaxhimin e burimeve njerëzore;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të Akt Emërimit të datës 01.04.2013, ka konstatuar se parashtruesi i ankesës mban pozitën e punës „Inspektor Nacional“ në Departamentin për Siguri publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike në punë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ky pretendim i ankuesit është i pabazuar sepse ankuesi shtesën në pagë për shkak të kushteve specifike e ka marrë në bazë të vendimit me nr.085 i datës 26.01.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë me vendimin me numër protokoll 667/2021 i datës 23.07.2021 ka pezulluar të gjitha vendimet e mëhershme të ish-Sekretarit të Përgjithshëm për aprovimin e shtesës mbi pagën bazë për kushte specifike të punës për stafin civil të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Arsyeja për pezullimin e këtyre vendimeve nga Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka qenë Raporti i Auditimit të brendshëm i datës 08.07.2021 me kërkesë të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se vendimi me numër protokoll 667/2021 i datës 23.07.2021 e Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i bazuar sepse qëllimi i këtij pezullimi të këtyre shtesave bëhet me qëllim të rishqyrtimit të bazës ligjore të lejimit të marrjes së këtyre shtesave mbi pagën bazë për kushte specifike të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se realizimi i shtesës për kushte specifike të punës për ankuesin mund të bëhet vetëm pas aprovimit nga institucionet

përgjegjëse respektivisht Ministria përgjegjëse për administratë publike, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 16 paragrafi 1, ku përcaktohet se: ... *institucioni kërkon miratimin e një shtese për kushte të punës për këta nëpunës civilë, sipas aktit nënligjor të përcaktuar në paragrafin 2. të këtij neni, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenit 7 paragrafi 3 ku përcaktohet se ... për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta, institucioni duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për Administratë Publike kërkesën që përmban: 3.1 arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte specifike të punës për pozitën (at) përkatëse; 3.2 listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civilë për çdo pozitë; 3.3 detajet, sipas të cilave, secila pozitë përkatëse pritet të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut; 3.4 koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushte specifike të punës.*

Kolegji konstaton se sipas raportit të auditimit të brendshëm të datës 09/07/2021, janë disa pozita zyrtare brenda këtij institucioni që janë përfshirë në këto shtesa por se neve nuk na është ofruar asnjë dëshmi mbi bazën ligjore të këtyre shtesave përveç një vendimi të ish Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme që përfshinë disa nga këto pozita të specifikuar në raportin e auditimit të vitit 2021, andaj me qëllim të rivendosjes së ligjshmërisë dhe mosdiskriminimit të zyrtarëve publik në këtë çështje, vendimi me numër protokolli 667/2021 i datës 23.07.2021 i Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i bazuar, dhe se është obligim i institucionit në këtë rast MPB-së, që lejimi i shtesave të caktuara të bëhet konformë procedurave ligjore të parapara në Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.1200/2021,datë 15.02.2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.